



**Kuvendi i Komunës Klinë**

01Nr. 06-14767 2023

Klinë, dt. 04,05, 2023

**PROCESVERBAL**

**Nga mbledhja e rregullt e punës së Kuvendit të Komunës të mbajtur me datë 31. 03. 2023 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.**

**Pjesëmarrës në mbledhje është kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj, nënkryetarja e Komunës, znj. Marqe Selamni, komandanti i policisë, z. Ragip Bytyqi, drejtorë të drejtorive, media lokale si dhe qytetarë**

Mbledhjen e hapi kryesuesi i Kuvendit z. Fadil Gashi i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit. Z. Gashi kërkoi që me një minutë nderim të përkujtohen të gjithë martirët e rënë në fshatin Pastasel në këtë datë kur po mbahet kjo seancë. Ai gjithashtu shprehu nderim për të gjithë dëshmorët dhe martirët e rënë anë e kënd Kosovës si dhe nderime për veteranët e luftës.

Të pranishmit nderuar me një ,minutë nderim

Kryesuesi në lidhje me rendin e ditës tha se ka një kërkesë për një pikë shtesë , kjo është kërkuar nga ministria e pushtetit lokal që ka të bëjë për vendim për rishikim.

**Rendi i Ditës u Miratua me 27 vota për.**

**Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi i mungesave**

U konstatua se të pranishëm janë 27 anëtarët e kuvendit

**Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.**

**Me 27 vota për ,a asnjë vërejtje U MIRATUA.**

**Pika 3 e Rendit të Ditës: Rekomandimet e KPF-së**

Kryesuesi kërkoi që të shqyrtohen tre rekomandime që nuk janë në rend të ditës. Kërkesa e parë është ajo e fshatrave Rigjevë, Gllarevë dhe Stapanicë që ka të bëjë për caktimin e një lokacioni për varreza. Në vazhdim kryesuesi lexoi rekomandimin e anëtarëve të komisionit nga drejtorja e Urbanizmit dhe tregoi se bazuar në

dokumente dhe harta zonale, komisioni rekomandon që të refuzohet kërkesa si e tillë dhe kërkon që kjo të bëhet me revidentin e hartave zonale në vitin e ardhshëm duke shikuar mundësinë e zgjerimit të hapësirave në zonën ku tani janë varrezat ose krijimin e hapësirave të reja për këtë qëllim.

**z. Esat Raci:** Kërkojmë që drejtoria përkatëse në bashkëpunim me qytetarët të ju bëhet zgjidhje atyre banorëve.

**z. Valmir Bacaj:** Sa i përket kërkesës së parashtruar pajtohem me rekomandimet e Komisionit në mënyrë që të gjendet një zgjedhje e përhershme.

**z. Zafer Gashi:** Sa i përket kësaj kërkesë, ne mendojmë që kjo kërkesë duhet të ju plotësohet qytetarëve.

**z. Arben limanaj:** Edhe ne si grup kuvendar e mbështesim kërkesën e këtyre tre fshatrave dhe jemi të ju bëhet zgjidhje.

### **Kryesuesi e vuri në votim rekomandimin e komisionit dhe me 27 vota për u MIRATUA.**

Kërkesa e dytë që nuk është në rend të ditës është kërkesa e shoqatës së peshkatarëve për turnirin tradicional që mbahet me 18 qershor. Kërkesa ka të bëjë me ndihmë mjete financiare në shumën 1500 euro. Në KPF kemi menduar që shuma të jetë 1000 euro me kusht që në vitin e ardhshëm shoqata t'i nënshtrohet thirrjes publike për subvencionim. Gjithsesi që shumës së ndarë të i bashkohet raporti i shpenzimeve më pastaj.

### **Me 27 vota për u MIRATUA**

Kërkesa e tretë është kërkesa nga organizatat e dala nga Lufta e UCK-së të cilët kërkojnë një shumë mjete prej 15 mijë euro për aktivitetet dhe shpenzimet gjatë tërë vitit. Kryesuesi theksoi se zgjidhja më e mirë do të ishte që të shihen mundësitë buxhetore me rishikimin e buxhetit.

**z. Esat Raci:** Me kërkesën e Organizatave të dala nga lufta, ne si grup kuvendar jemi shumë dakord dhe e mbështesim plotësisht. Këto organizata i akne kryer gjithmonë të gjitha aktivitetet siç janë ato të varrimeve të veteranëve, përkujtimet etj. Jemi dakord që kjo të shkoj me rishikim të buxhetit.

**z. Zafer Gashi:** Edhe ne e përkrahim këtë kërkesë dhe pajtohem që kjo të bëhet me rishikim të buxhetit. Sidoqoftë mendoj që këto mjete mund të gjeten lehtë pasi që mund të merren nga grandit i performancës.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Askush nuk po e konteston arsyen e kërkesës por nganjëherë edhe 100 euro është zor që të gjinden pasi që kur po e bëjmë ndarjen buxhetore nuk po interesohemi. Në këtë rast rishikimi bëhet nga qershori dhe kjo varet nga qeveria, natyrisht do ta shikojmë mundësinë. Në staza të gjata ndoshta është më mirë që të ju bëhet një ndarje e tillë e mjeteve. Në këtë rast nuk do të kishte ngarkesë komuna organizimin e këtyre aktiviteteve. Prap po e them kur të ju

behët subvencionimi dhe ndarje të mjeteve organizatave pavarësisht cilës, është mirë dhe duhet të kemi raport kthyes për shpenzimet e atyre mjeteve.

**z. Valmir Bacaj:** Në mënyrë që të ju bëhet zgjidhje afatgjate organizatave në fjalë mendoj që kërkesa është shumë e arsyeshme. Pajtohemi që këtë mundësi ta shikojmë me rishikim të buxhetit.

**z. Arben Limanaj:** Edhe ne jemi dakord me kërkesën e organizatave të luftës dhe jemi që të shikohen mundësitë buxhetore dhe të ju plotësohet kjo kërkesë.

**Kryesuesi e vuri në votim mundësinë buxhetore me rishikim të buxhetit dhe me 27 vota U MIRATUA.**

Pas votimit të rekomandimeve fjalën e morri z. Zafer Gashi dhe tha se është hera e tretë që po pyet kryetarin në lidhje me kërkesën për ndihmë të veteranit Sokol Gashi nga Sferka i cili fare nuk është ndihmuar akoma edhe pse personi e ka kryer operacionit. Po ashtu nuk janë kompensuar bizneset dhe qytetarët e dëmtuar nga vërshimet e para. "Kam 4 muaj që kam kërkuar nga kryetari një raport për shumën e ndarë për këto kategori dhe akoma nuk e kam marr përgjigjen" theksoi në fund z. Zafer Gashi.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Në lidhje me kërkesën e z. Sokol Gashi, besoj që është në proces por merr pak kohë deri të kaloj regjistrimi si furnitor i ri. Çështja e kompensimit të dëmeve jemi në pritje për vlerën që do të ndaj qeveria. Kemi pasur takime të shumta edhe me komisionin në nivel qendror dhe jemi në pritje të tyre.

**Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi për shpalljen e zonave me interes publik sipas kërkesës së drejtorisë së Urbanizimit.**

**z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit:** Përshëndetje. Drejtoria ka bërë kërkesë për shpallje interes publik të katër parcelave. Të gjitha këto parcela janë në interes të qytetarëve dhe shërbimin e tyre. Këto parcela i përshkon rruga që gjithashtu është në interes të qytetarëve.

Kryesuesi theksoi se sot merret vendim vetëm që të shpallen zona të interesit publik dhe tek më pastaj janë shumë procedura që kërkohen për këmbim prone.

**Me 27 vota për U MIRATUA**

**Pika 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për ndarjen e mjeteve për mbajtjen e festivalit folklorik " I këndojmë Lirisë"**

**Me 27 vota për U MIRATUA**

**Pika 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të kryetarit të komunës për subvencionimin e qirasë së banimit për N.G.**

Kryesuesi theksoi se është një kërkesë e ardhur nga zyra e kryetarit dhe një vendim nga seanca e kaluar. Duhet që të caktohet shuma e mjeteve theksoi z. Gashi. Kërkesa është që për periudhën një vjeçare, N.G të i ndahet shuma prej 1800 euro.

#### **Me 27 vota për u MIRATUA**

**Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për zëvendësimin e anëtarit të KKSB-së.**

Kërkohet zëvendësimi dhe që don Jeton Thaci të jetë anëtar i ri i KKSB-së.

#### **Me 27 vota për U MIRATUA.**

**Pika 8 e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarëve të komiteteve.**

Kërkohet zëvendësimi i znj. Tanja Kostic nga Gjura Krasic në komitetin për komunitete.

#### **Me 27 vota për U MIRATUA**

Kërkohet gjithashtu zëvendësimi i z. Bastri Gashi nga Sefë Morina, i cili u propozua në këtë mbledhje, në Komitetin për shërbime publike.

#### **Me 27 vota për U MIRATUA**

**z. Esat Raci:** Kur jemi tek zëvendësimi i anëtarëve të komitetit. Ne grupi ynë kuvendar propozon që të zëvendësohet, z. Asdren Ramadani nga z. Adnan Qupevaj në komitetin për Urbanizëm.

#### **Me 27 vota për U MIRATUA**

**Pika 9 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i draft rregullore Komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Klinës.**

Kryesuesi theksoi se janë mbajtur dëgjime publike, është debatuar dhe kanë ardhë disa propozime etj. Sot është koha kur do të shqyrtohet dhe merret vendim. Z. Gashi tregoj për dy kompanitë që operojnë në komunë dhe për kapacitetet, të arriturat dhe vështirësitë e tyre.

Për rregulloren e hartuar foli edhe drejtori i shërbimeve publike z. Qendrim Millaku. Ai bëri një përshkrim të procedurave që kanë rrjedhur, tregoj gjithashtu edhe për disa pika të shtruara në këtë rregullore.

**z. Valmir Bacaj:** Draft rregulloren e kemi shqyrtuar edhe në komisionin e aksionarëve të kompanisë "Ambienti" në Klinë. Po ashtu edhe në KPF. Rekomandimi i KPF ka qenë që tarifa për amvisëri ka qenë 6.5 të zbritet në 6 euro e po ashtu tek subjektet e mesme dhe të mëdha tarifa nga 40 euro të zbritet në 35 euro.

z. Bacaj jepi disa të dhëna në lidhje me shpenzimet që njësia në Klinikë paguan dhe tregoj që me çmimet që janë tash, tarifën, KRU "Ambienti" në Klinikë operon me humbje prandaj rritja e këtyre tarifave është e domosdoshme.

**z. Zafer Gashi:** Unë kam një pyetje. Njësia "ambienti" a është në menaxhim të regjionit apo ne po flasim se si duam të jenë çmimet, tarifën kur kjo njësi të futet në menaxhim të komunës. Sa i përket tarifave për amvisëri pajtohemi por shuma për biznese mendoj që për disa është e pa përballueshme duke ditur që bizneset janë të ndryshme e edhe krijimi i mbeturinave prej tyre është e ndryshme.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Rregullore kemi pasur edhe para kësaj. Rregullorja e përcakton tregun, tarifën pavarësisht se a është regjionale apo komunale. Propozimi për zbritje të tarifave nga 6.5 në 6 si dhe ajo nga 40 në 35 nuk është qëllimi që të ngufatim as amvisërinë as bizneset. Në këtë rregullore janë të kategorizuara tarifën bazuar nga aktiviteti i biznesit.

**z. Esat Raci:** Realisht kam pritur që në këtë draft të bëhet ky ndryshim tek neni 23 por nuk qenka bërë. (ndërhynë kryesuesi duke theksuar se te neni 23 e përmirësojmë sot me vendimin tonë) Grupi ynë kuvendar jemi dakord që të procedohet sipas dakordimit në KPF, d.m.th. për amvisëri të jetë tarifa 6 euro.

**z. Arben Limanaj:** Edhe ne si grup mbështesim rekomandimet e KPF-së. Tarifën për biznese nëse është e mundur zbritja do të ishte mirë sepse kriza i ka prek edhe bizneset.

**z. Tunë Dedaj:** Përsëritje të gjithëve. Dua të falënderoj të gjithë anëtarët e KPF kanë qenë dakord që nga 6.5 të kthehet në 6 euro tarifa për amvisëri familjare. Pagesat deri tani kanë qenë 95% dhe me rritjen 6.5 kam pasur frikë që do të ndikoj negativisht. Sa i përket tarifës për biznese, unë i kam tre lokale të hapura dhe kam propozuar që të rritet.

**z. Valmir Bacaj:** Sa i përket bizneseve janë 4 kategori. Nuk ju rritet tarifa të gjitha bizneseve. Varësisht nga madhësia e biznesit dhe sa krijon mbeturina. Kategoria e fundit, më e madhja industri të rënda është 40 euro e jo bizneset e vogëla.

Kryesuesi kërkoi që të ketë edhe një ndërhyrje në rregullore tek neni 24 tek faturimi i mbeturinave ku thuhet se konsumatori obligohet që ta paguaj faturën e mbeturinave çdo muaj ndërsa në paragrafin e dytë tjetër thotë se konsumatori është i obliguar që ta paguaj faturën në 4 këste. Të dyja obligative nuk mund të qëndrojnë.

**z. Dardan Bashota, zyrtar:** Ke të drejt kryesues. Duhet të hiqet ajo që konsumatori të paguaj në katër këste për arsye se kompania në sistemin e tyre nuk mund të realizoj. Ndërsa paragrafi 5 ku thotë se konsumatori mund të paguaj faturat për 6 muaj ose një vit edhe kjo duhet të hiqet për shkak të sistemit të brendshëm të kompanisë, d.m.th. softueri i kompanisë. Pra të hiqet paragrafi i dytë dhe i pestë te neni 24.

**z. Kushtrim Haliti:** Unë dua të ndërlidhem tek kjo që thotë se konsumatori mund të i bëjë për 12 muaj parapagim.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Ndalesa nuk është. Ti mund ta bësh pagesën për 12 muaj por përfitim në zbritje nga kompania në këtë rast nuk ka.

**Znj. Ilirjana Toplanaj:** Përshëndetje. A mund ta dijë nëse keni parë ndonjë plan të riciklimit që të i bashkohet rregullores?

Kryesuesi, z. Gashi tha se plani komunal për menaxhim të mbeturinave është në vazhdim.

**Pas debatit, kjo draft rregullore me ndryshime u vendos në votim dhe me 27 vota për u MIRATUA.**

**Pika 10 e Rendit të Ditës: Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave.**

**z. Dardan Bashota, zyrtar:** Sot para juve e keni planin komunal për menaxhim të mbeturinave që është një plan 5 vjeçar. Mendoj që është një dokument i punuar shumë mirë që bazë e ka ligjin për menaxhimin e mbeturinave. Ky plan gjithashtu është në harmoni të plotë me strategjinë e qeverisë për menaxhimin e mbeturinave. Ky plan e thekson shumë qartë që komuna menaxhon me mbeturinat që janë në kompetencë të saj sepse ka edhe mbeturina që nuk janë në kompetencë të komunës por të ministrisë përkatëse. Synoj që në të ardhmen të marrin përsipër edhe faturimin dhe inkasimin e pagesave për këto mbeturina.

**Hapet debat.**

**Znj. Ilirjana Toplanaj:** Dëshiroj të pyes se si e kanë menduar që të bëjnë riciklimin e mbeturinave.

**z. Dardan Bashota, zyrtar:** Në faqen 35 të planit e keni skemën e zbatimit të planit për riciklim të mbeturinave, transportin e tyre. Mbeturina të riciklueshme dhe biodegradushme. Komuna e Klinës është e obliguar që të bëjë një studim fizibiliteti se si do të bëjë ndarjen dhe riciklimin sipas modelit të operimit, grumbullimit, transportit. Thuhet aty se do të ketë edhe disa oborre ricikluese që ne mendojmë si komunë dhe sektor i mbrojtjes së mjedisit këto oborre ricikluese do ti kemi në shkollën e mesme dhe në disa shkolla të tjera në fshatra. Qëllimi është gjithashtu vetëdijesimi i qytetarëve për riciklimin e mbeturinave dhe Baza e planit është tek 3R, Redukto, ripërdor dhe riciklo mbeturinat.

**z. Zafer Gashi:** Sqarimi i dardanit ishte shumë i mirë por dëshiroj që të ja bëjë disa pyetje. Ju e përmendet se do të shikohet mundësia e marrëveshjes me një riciklues privat. A do ta merr pa para ai sepse është biznes aty. Ndoshta kryetari duhet të shikoj të gjejë prap ndonjë biznesmen jashtë vendit që do të investoj dhe punësoj njerëz.

**z. Dardan Bashota, zyrtar:** Ne kemi një bashkëpunim të mirë me agjensionin për mbrojtje të mjedisit, aty raportohet çdo muaj nga ne. Ekspertet e këtij agjensioni

kanë shprehur gatishmërinë që të vijnë nëpër komuna dhe të sqarojnë modelin e riciklimit të mbeturinave. Nëse plani do të miratohet sot, Komuna e Klinës do të hap një qendër të pranimit dhe ripërdorimit të mbeturinave. Sqarime se si do të bëhet kjo do të ketë nga ekspertë edhe përmes radiove dhe mediave tjera lokale. Komuna e Klinës ka përfituar kohë më parë një donacion afër 620 mijë euro si rezultat i punës në sektorin e mjedisit. Edhe këtë vit presim që të kemi një grand nga qeveria dhe GIZI.

Kryesuesi theksoi se ne pas miratimit të këtyre dokumenteve do të operojmë përmes tyre dhe nuk ka me pas qasje askush tjetër. Ne po i miratojmë vet këto dokumente nuk po na i miraton kryetari prandaj është e padrejtë me thënë ndryshe.

**z. Kolë Prenaj:** Përshëndetje. Ilirjana e hapi një temë që ja vlen të bisedohet. Për mua është një ndryshim i madh krahasuar para disa viteve. Investim i veçantë duhet tek vetëdijesimi dhe informimi. Kam vizituar disa shtete në lidhje me menaxhimin e mbeturinave. Uroj që ai sistem të vijë edhe tek ne. Çdo kund në përfundim vetëdijesohet në lidhje me mbeturinat që nga kuzhina deri tek përfituesi. Duhet të mendohet shumë prej riciklimi deri te deponimi. Këto tema nuk po i debatojmë , është mirë që të ngritën nga biologët, agronomet etj.

**Kryesuesi e vuri në votim dhe me 26 vota sa ishin edhe prezent U MIRATUA.**

**Pika 11 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi për vënien në diskutim publik të draft strategjisë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun 2023-2026**

**Znj. Vlora Tafili, zyrtare për informim:** Përshëndetje e nderuara nënkryetare e komunës, i nderuar kryetar i komunës, kryesues, drejtorë, asamblistë. Një kërkesë kam në start dhe i përket strategjisë së komunikimit, që të pajiset ky kuvend edhe me dy apo tre mikrofone sepse me vetëm një nuk po mbulohet si duhet. Para juve do ti shpalosi dy dokumente. Strategjia është një dokument por për shkak të performancës na duhen dy vendime. Pra janë dy dokumente, Strategjia dhe plani i veprimit. Në mbështetje të kryetarit të Komunës, OSBE, grupit punues në krye me nënkryetaren, ekspertit të jashtëm z. Valon Canhasi kemi arritur me i hartuar këto dy dokumente dhe besoj se kemi avancuar disa hapa institucionin drejt transparencës komunale, kemi arritë që të i përmbushim rekomandimet e zyrës për integritet evropiane. Këto dy dokumente nga sot dalin në diskutim publik dhe deri të votohen nga ju nëse keni ndonjë pyetje jam gati të përgjigjem.

**Kryesuesi tha se tashmë është praktikë , këto dokumente do të vijnë prap në kuvend për trajtim pasi të kryhet afati i diskutimit publik dhe e vuri në votim ku me 26 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Gjithashtu edhe draft plani i veprimit me 26 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 12 e Rendit të Ditës: Vendimi për destinimin e parcelës për ndërtimin e shtëpisë për strehim dhe përkujdesje të personave të moshuar.**

Kryesuesi tha se nuk ka pasur nevojë të merret vendim, ekzekutivi e ka pas rrugën e hapur që të veprojë duke u bazuar në hartat zonale.

**Me 26 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim u ANULUA vendimi i referuar me emër dhe numër.**

### **Pika 13 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje**

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Javën e kaluar kam dëgjuar që në Ujmir janë bërë disa gërmime. Kush janë ata që akne bërë gërmime , çfarë është kërkuar?

**Znj. Fatjona Gashi, drejtore e DKRS:** Po e vërtetë, ne jemi informuar dhe kemi shkuar duke parë vendin ku janë bërë gërmimet. Nuk e dimë se kush janë ata që kanë bërë gërmime. Rezulton që aty ka të bëjë me disa gjetje arkeologjike dhe ne menjëherë e kemi njoftuar institutin përkatës në Prishtinë. Për gjetjen e personave që kanë bërë gërmime na ka mbetur që nëse është e nevojshme të njoftohet stacioni i policisë.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Që tani të pajtohemi që të nisim hetimet sepse mendoj që aty është konsumuar vepra penale. Askush nuk guxon që të bëjë gërmime në komunën e Klinës pa njoftim të Komunës.

**Znj. Besiana Gashi:** Pyetja: Pse u ndalu projekti për shtegun e biçikletave dhe trotuarit për këmbësor dhe nuk vazhdoj deri tek ura?

**z. Enver Berisha, drejtor i urbanizimit:** Sa për informim, shtegu nuk ka përfunduar akoma dhe jemi duke e vazhduar projektin.

**z. Kushtrim Haliti:** z. Kryetar, "Malishgani" që është privatizuar, në një takim me ish punëtorët e këtij kombinati vitin e kaluar keni premtuar që deri në vitin 2023 do të ju epen mjetet 20% që ju takojnë atyre por akoma nuk është bërë. Pyetje: Drejtorin e bujqësisë- kur do të nisë komisioni për ndarjen e serave dhe a keni mjete shtesë për ndihmë fermerëve që kanë shtalla? Pyetje: Drejtorinë e shërbimeve publike- a jeni në dijeni se një pronë e komunës në qendër është dukë u shfrytëzuar si parking dhe nuk paguan taksa.? Pyetje: Drejtorinë e urbanizmit: Shtyllat me drita të vendosura aq afër rrugës në drejtim të urës së Drinit, a e keni pasur në projekt ashtu sepse vendosja e tillë është shumë e rrezikshme.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Prona " Malishgani" nuk është privatizuar, ka qenë një vendim i kryeministrit Haradinaj, pastaj këtë vit është tërheq nga kryeministri Kurti. Ne jemi duke pritë që të na japin vlerësimin e pronave dhe jemi në rrugë që ta kthejmë në pronë komunale. Kur kjo të bëhet sigurisht që do të kryhen të gjitha procedurat e parapara me ligj.

**z. Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë:** Kemi një fitues të tenderit për sera dhe nga java e ardhshme do të nis me shpërndarje të serave menjëherë sa të kryej punën komisioni i cili është duke punuar. Kemi shumë pasoja të vërshimeve



gjithashtu dhe me grandin e përformancës , kryetari i ka nda 50 mijë euro për renovim të rrugëve fushore dhe pastrimin e proçkave.

**z. Enver Berisha, drejtor i urbanizmit:** Sa i përket projektit të shtegut të ecjes nuk ka përfunduar akoma ai projekt. Mendojmë që duhet pritur përfundimin e projektit, shqetësimi tuaj për shtyllat elektrike do të i epet zgjidhje. Kemi menduar që rruga të zgjerohet edhe për një metër në anën tjetër. Do të vendoset një vijë e plotë që nuk lejon ofrimin me shtyllat. Një rrugë magjistrale të njëjtë e ke në Banjë të Pejës. Ndërsa sa i përket pllacit që e përmendet për parking, qytetarë të pa ndërgjegjshëm ka.

**z. Kushtrim Haliti:** Edhe aty nëse lejoni papërgjegjësi , në qendër të Klinës s'di ku do ta ndaloni tjetër kund.(i kërkohet që ta thotë emrin e personit dhe z. Haliti thekson se personi për të cilin po flitet është Sokol Elezaj)

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** E diji që personi që i referoheni ka paguar taksën komunale 10 euro për metër katrorë, e ka me qira hapësirën.

z. Haliti theksoi në vazhdim se ka qenë në drejtori dje dhe e ka parë që personi në fjalë nga dhjetori i vitit të kaluar nuk ka paguar asnjë taksë.

Kryetari i komunës tha se tani është bërë një thirrje e re për shumë raste të tjera, për të gjithë ata që akne bërë uzurpim të pronës komunale dhe inspektorati do të dalë të i kontrolloj të gjitha këto.

Kryesuesi i kuvendit u angazhua në këtë debat të vogël duke thënë se meqenëse jemi këtu kam një shqetësim në lidhje me shtegun për këmbësor në qendër. Personat apo operatorë ekonomik që marrin hapësirat me qira ngjitur me shtegun po vendosin lule dhe vazo duke mbyllur shtegun për këmbësor. Është mirë që inspektorati të merret më këtë punë.

**z. Enver Gashi:** Përshëndetje. Kam një pyetje për drejtorin e DKA. Kur do të filloj punën çerdha e fëmijëve që është e re e ndërtuar?

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Janë dy shkresa me të cilat i jam drejtuar Ministrisë së arsimit por prap punimet nuk kanë vazhduar. Kemi pasur edhe një kronikë televizive për këtë problem. Do të ishte mirë që MASHT projektet që i nisë të i përfundoj e jo ti leje kështu siç e ka lënë çerdhen e fëmijëve në Klinë.

**Znj. Marigona Raci:** Përshëndetje. Kam nj pyetje për drejtorin e shëndetësisë. Çfarë funksioni akne AMF-të dhe QMF-të në komunën tonë? Si kund të funksionojnë kur nuk ka mjek por vetëm infermierë dhe ka mungesë të barnave esenciale. Qytetarët gjithashtu akne ankesa për mos respektim të orarit të punës të barnatoreve.

**z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë:** Është e vërtetë që barnatoret nuk po e respektojnë orarin e punës. Unë i kam takuar pronarët e të gjitha barnatoreve dhe ata më kanë thënë se akne mungesa të farmacistëve të licencuar. E kanë një i cili

nuk mund të rrijë 24 orë në barnatore. Sidoqoftë ky problem duhet rregulluar dhe një barnatore duhet të jetë kujdestare tërë natën. Sa i përket AMF dhe QMF-ve, në QMF ka mjek ndërsa në AMF ka vetëm teknik medicine. Në QMF mjekët punojnë me orar të caktuar jo çdo ditë sepse ka mungesë të mjekëve. Në AMF kryhen shërbimet që i kryen një teknik medicine dhe për raste të tjera dërgohet në QKMF. Sa i përket mungesës së barnave nga lista esenciale ne jemi munduar që të i plotësojmë këto barna që mungojnë por gjithashtu kemi marr një zotim nga ministri i shëndetësisë që do të plotësohet lista dhe shpresojmë që do të jetë ashtu nga java e ardhshme.

**z. Zafer Gashi:** Kryetar përmendet një njoftim për aplikim të shfrytëzuesve të shesheve, hapësirave, panove reklamuese etj. A mos është kjo një amnisti për të gjithë ata uzurpator që kanë shfrytëzuar me vite hapësirat publike. A mund të ma shpjegoni një rast ku një personi ju ka rrëzuar një pjesë e lokalit dhe ai tani në vend që ta shfrytëzoj për verandë ka bërë prap ndërtim? Investimi që është bërë në Sferkë në projektin e parkut është qesharak, s'di a keni parë diku park me vetëm 500 metra katrore? I kam disa foto këtu, më shumë ka beton se sa gjelbërim në atë park 25 metra gjerë dhe 25 metra gjatë. Nuk dihet kush e kryen punën, dhe as nuk dimë se sa është kosto e atij projekti. Kur e kemi propozuar këtë projekt ne kemi menduar që do të ketë shumë hapësira të tjera si ato sportive etj. Për z. Bacaj, drejtorin, a keni vendosur diçka në lidhje me vendimin e datës 31. 01. 2023, keni një rekomandim. Kam thënë që 17 lëndë që 4 muaj në shkollën "Fehmi Agani" drejtimi i farmacisë janë dhënë nga dy veta. 9 lëndë nuk janë dhënë fare në fakt por vetëm janë shkruar në ditar. Mendoj që kjo punë mund të shkoj edhe në organet e hetuesisë.

Kryesuesi tha se të gjithë anëtarët në sallë është aprovuar ai buxhet e edhe ai projekt me atë buxhet.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Prejudikimet janë të vështira por ai që donë ta kuptoj drejt Rregullorja është për dhënie në shfrytëzim të hapësirave deri për një vit dhe ajo që është rrezuar nuk ndërtohet më. Bëhet fjalë për uzurpime të shumta por nuk mundet të ndërtoj një person diçka për kohë afatgjate derisa leja është për shfrytëzim për një vit. Ata që nuk kanë qenë të rregullt do të vizitohen nga e hëna prej inspektoratit. Ne kemi aprovuar një rregullore që lehtëson gjithsesi por nuk i jep të drejta për shfrytëzim të natyrave konsensionale. Parku në Sferkë ka kushtuar 15 mijë euro. Me këto mjete aq kemi pasur mundësi të ndërtojmë. Mendoj që është një fillim i mirë ku do të ketë edhe lodra për fëmijë dhe hapësirë për qëndrim të mbuluar.

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Ne kemi pasur një ankesë dhe mirë që e kemi inspektoratin dhe ka sjell një rekomandim që është vetëm një: Njëri nga kandidatët që është përzgjedhë në atë kohë që s'ka pas kandidat të tjerë është pranuar që mos të lihen nxënësit pa mësim. Nga ankesa e dikujt, inspektorati ka kërkuar që të kthehet në pikën zero dhe e kemi kthyer. Nuk është mirë që të kihet qëllim të dëmtohen institucionet.

Reagon z. Zafer Gashi kërkon fjalën por fjala nuk i epet. Këtu nis një debat interaktiv në mes të Zafer Gashit dhe drejtorit Qemajl Sejdiu që është e pamundur të mbahet shënim.

**Znj. Valmira Krasniqi:** Përshëndetje. Kam dy pyetje. 1. Për drejtorin e SHP- tek ura e lumit " Klina" është prish trotuari dhe po paraqet rrezik për këmbësor e sidomos për fëmijët që kalojnë në atë pjesë. Po ashtu aty është prishur edhe ndriçimi publik, ka tela të rrymës të shtrirë në tokë. Është e papranueshme qysh këta vet kalojnë andej dhe nuk akne intervenuar akoma. Pak përtej është një lagje ku aty janë grumbulluar qentë endacak, para disa muajve është sulmuar një fëmijë nga ata qenë. Për drejtorin e shëndetësisë- a ka në QKMF Psikolog?

**z. Agron Bacaj, drejtor i shëndetësisë:** Në QKMF nuk ka punëtor të punësuar si psikolog. Kemi kontratë me kompani ku një psikolog kryen punën në QKMF. Shërbimet që kryhen në shërbimin parësor nuk i përcakton as Komuna as drejtoria por nga ligji për shëndetësi dhe udhëzimi administrativ i ministrisë së shëndetësisë.

**Znj. Ilirjana Toplanaj:** Tek thirrja për aplikimin për sera, kriteret që duhet të plotësojnë fermerët e shohë që për herë të parë nuk kërkohet Certifikata e Fermerit. A mund ta dijë se si i keni identifikuar fermerët?

**z. Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë:** Serat këtë vit janë në sipërfaqe më të vogla. Që mos të diskriminohen fermerët e vegjël që mund të mos jenë fermer, në mënyrë që mos të aplikojnë në ministri për grande ne jua kemi mundësuar që edhe ata të kenë mundësi të aplikojnë për sera. Me 10 ari e 20 ari ata nuk mund të aplikojnë në ministri për subvencione dhe ju kish humbë e drejta që të marrin një serë qoftë fermer apo jo fermer. Për një ekonomi familjare, hapësira prej 30 metra katrorë është shumë e vogël.

#### **Pyetja e fundit**

**Znj. Lirie Gashi:** Përshëndetje. Edhe unë kam një pyetje për drejtorinë e shëndetësisë. – Pse në QKMF në stomatologji nuk ka material për rregullimin e dhëmbëve?

**z. Agron Bacaj, drejtor i shëndetësisë:** Është shqetësim me vend. Unë prej që kam ardhur drejtor kam kërkuar që të ketë material për rregullimin e dhëmbëve në stomatologji. Më kanë premtuar që kanë me e bërë listën e nevojave dhe në momentin që do ta përgatisin listën edhe kryetari do të na ndihmojë që të plotësohet edhe ky shërbim.

Kryesuesi konstatoj se në fund të kësaj mbledhje janë 19 anëtarë prezent dhe shpall të mbyllura punimet e kësaj seance.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi:

Fadi Gashi